



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

NR.RREGJ.THEM.392

V E N D I M
“NE EMER TE REPUBLIKES”



“PER MIRATIMIN E SHPERNDARJES PER FUNDIMTARE”

GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANË, E PERBERE NGA:

MARINELA OSMANI – GJYQTARE

Sot me date 09.03.2018, mori ne shqyrtim, pa pranine e paleve dhe ne dhome keshillimi, kerkesen civile tregtare, qe i perket:

KERKUESE: Shpresa Breçani, Administratore e Falimentimit e Shoqerise “Albanian Airlines” sh.p.k, ne falimentim.

OBJEKTI: Miratimin e shperndarjes perfundimtare te mases se falimentimit per Shoqërine “Albanian Airlines” sh.p.k, shoqeri ne falimentim.

BAZA LIGJORE: Nenet 159 dhe vijues te ligjit Nr.8901, date 23.05.2002 “Per falimentimin”, i ndryshuar.

Gjykata, ne perfundim te shqyrtimit te kerkeses, si me lart:

V E R E N

1. Shoqëria “Albanian Airlines” sh.p.k është një shoqëri tregtare e regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit Tirane ne date 16.05.1995. Kjo shoqëri ushtron aktivitetin tregtar në fushën e transportit ajror të mallrave e të pasagjereve me mjetet e transportit ajror të blera prej saj si dhe të marra ose dhëna me qera te tyre, veprimtari të agjensië të udhëtimit e shitjes së biletave, aktivitet magazinues e spedicioner si dhe administrim e operim e akomodim i pasurive të paluajtshme në aerorporte që i sherbejn kësaj veprimtarie, veprimtari riparuese, pastruese e meagazinuese avjonesh ose pajisje të tyre, veprimtari

catering, (pergatitja dhe furnizimi me ushqime dhe pije) dhe/ose ajo e Self Catering-ut (vetfurnizim).



2. Me vendimin Nr.3678, date 21.04.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane ka vendosur:

- Pranimin e kerkeses se kerkuesit Shoqeria “HAVAS –HAVAALANLARI YER HIZMETLERI A. S” Sh.p.k.
- Hapjen ne oren 14:00, te dates 21.04.2016, te procedures se falimentimit te Shoqerise “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., me administrator Yahia Farëati, me seli në adresën : Sheshi Avni Rustemi, Pallati Teuta Construction, Kati i 1 , Tiranë, Shqipëri
- Emerimin si administratore te falimentimit, per Shoqerine “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., te znj. Shpresa Breçani, e licensuar nga Ministria e Drejtesise, me licencen Nr.9, date 14.10.2014, me Adrese: Rruga “Jordan Misja”, P. Sara El, Shk. 1, Ap.1, Tirane.
-

3. Ne momentin e shqyrtimit te kerkeses objekt gjykimi, Gjykata veren se jane mbajtur mbledhja per raportim dhe mbledhja per verifikimin e pretendimeve, te cilat kane perfunduar me miratimin e tabelave perkatese te pretendimeve te kreditorëve te Shoqerise “Albanian Airlines” shpk, ne falimentim, si dhe, ne baze te informacionit te marre, eshte likuaduar teresisht masa e falimentimit e mbledhur nga administratorja.

4. Procedura e falimentimit eshte drejt perfundimit dhe jane krijuar likujditete per te mbyllur shpenzimet e procedures se falimentimit dhe kryer shperndarjen perfundimtare.

Ne lidhje me parashikimet ligjore ne perputhje me kerkesen, Gjykata veren se:

5. Neni 159 i ligjit Nr.8901, date 23.05.2002 “Per falimentimin” (i ndryshuar) parashikon: *“1. Shperndarja e fundit bëhet sapo të përfundojë shitja e masës së falimentimit. 2. Shperndarja e fundit bëhet vetëm me miratimin e seksionit tregtar të gjykatës së rrethit.”*

6. Neni 160 i ligjit Nr.8901, date 23.05.2002 “Per falimentimin” (i ndryshuar) parashikon mbledhjen përfundimtare: *“1. Kur jep pëlqimin për shperndarjen përfundimtare, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit përcakton edhe afatin për një mbledhje përfundimtare të kreditorëve. Gjatë mbledhjes: a) diskutohen llogaritë e paraqitura nga administratori i falimentimit; b) paraqiten vërejtje ndaj listës përfundimtare; c) vendosin për sendet që janë pjesë e masës së falimentimit dhe të papërshtatshme për shitje. 2. Periudha kohore ndërmjet shpalljes së datës së mbledhjes dhe mbledhjes nuk mund të jetë më pak se tri javë dhe jo më shumë se një muaj. 3. Për vendimet e gjykatës për vërejtjet e një kreditori zbatohen, sipas rastit, parashikimet e pikave 2 dhe 3 të nenit 157 të këtij ligji.”*



Neni 157, pika 1 dhe 2 e ligjit parashikon se: “...2. Çdo vendim i gjykatës që hedh poshtë këtë vërejtje duhet t’u dërgohet kreditorit dhe administratorit të falimentimit. Kreditori ka të drejtën e ankimit të veçantë ndaj këtij vendimi. 3. Vendimi i gjykatës që urdhëron një ndryshim në listë, u njoftohet kreditorit dhe administratorit dhe depozitohet në regjistrin e gjykatës për t’u inspektuar nga palët. Administratori dhe kreditorët e falimentimit kanë të drejtën e ankimit të veçantë ndaj vendimit. Afati i ankimit fillon nga data kur vendimi është depozituar në regjistrin e gjykatës.”

8. Neni 163 i ligjit Nr.8901, date 23.05.2002 “Per falimentimin” (i ndryshuar) parashikon: përfundimin e procedurës së falimentimit: “1. Sapo të jetë kryer shpërndarja përfundimtare, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos mbylljen e procedurës së falimentimit. 2. Vendimi dhe shkaku i mbylljes shpallen publikisht.”

Ne përfundim të shqyrtimit të kërkesës, pas analizës së faktit dhe të parashikimeve në ligj, Gjykata verën se kërkesa është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë ajo duhet të pranohet.

9. Procedura e falimentimit përfaqëson procesin e likuidimit të një subjekti që ndodhet në kushtet e paaftësisë paguese apo mbingarkesës së tij me borxhe. Kjo procedure ka për qëllim likuidimin e subjektit, nëse gjykohet se shitja e pasurive të tij, do të jetë me përfitim për kreditorët.

10. Aktualisht, janë përfunduar procedurat e falimentimit si Mbledhja për Raportim, Verifikimi i Pretendimeve të Kreditorëve dhe ka përfunduar shitja e të gjitha asetëve të gjetura nga vete administratorja.

11. Me shkresën Nr.652Prot. date 11.02.2018, nga ana e Gjykatës i është kërkuar administratorës një informacion për procedurën dhe njëkohësisht kryerja e veprimeve të caktuara. Në kuadër të këtyre veprimeve rezultoi se është dhe mbledhja e Komitetit të Kreditorëve të datës 16.02.2018, i cili ka miratuar një ndryshim në rradhën e preferimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil. Sipas këtij informacioni rezultoi e provuar se masa e falimentimit e grumbulluar dhe është likuiduar teresisht, nuk ka me masë falimentimi dhe jemi në kushtet proceduriale për të vijuar me shpërndarjen e vetme dhe të fundit dhe me pas për të diskutuar për mbylljen e procedurës së falimentimit, me anë të caktimit të mbledhjes përfundimtare.

12. Nga ana e administratorës së falimentimit me shkresën e depozituar me Nr.559Prot., date 02.03.2018 është venë në dispozicion tabela e shpërndarjes përfundimtare për masën e falimentimit në shumën 11,319,535 leke. Me njoftim paraprak dhe me pas me shkresën Nr.6095Prot., date 09.03.2018, administratorja e falimentimit ka depozituar tabelën përfundimtare të shpërndarjes në shumën 10,283,982 leke, që ka rezultuar si rrjedhojë e

ndryshimet te kursit te kembimit te dollarit ne date 08.03.2018 nga llogarine e Bankes Kombetare Tregtare.



PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar ne nenet 159 dhe vijues te ligjit Nr.8901, date 23.05.2002 "Per falimentimin"
(i ndryshuar)

V E N D O S I

1. Pranimin e kerkeses.
2. Miratimin e shperndarjes perfundimtare te mases se falimentimit ne shumen 10,283,982 leke, sipas shumave dhe rradhes se preferimit te vendosur per çdo kreditor, sipas tabelës se paraqitur nga Administratorja e Falimentimit e Shoqerise "Albanian Airlines" sh.p.k, ne falimentim, bashkelidhur dhe pjese e ketij ketij vendimi.
3. Shperndarja e mases se falimentimit, sipas tabelës se miratuar, do te behet nga Administratorja e Falimentimit e Shoqerise "Albanian Airlines" sh.p.k, ne falimentim, pas diskutimit te verejtjeve sipas neneve 160 dhe 157 te ligjit, ne mbledhjen perfundimtare te kreditorëve te falimentimit, ne afatet dhe menyren qe do te caktohet nga Gjykata ne kete mbledhje.
4. Caktimin e mbledhjes perfundimtare te kreditorëve te falimentimit, e cila do te mbahet ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane, ne date 29.03.2018, ora 11:00, kati i trete, salla Nr.5. Mbledhja perfundimtare e kreditorëve te falimentimit do te kete si rend dite:
 - a. Diskutimin e llogarive te paraqitura nga administratori i falimentimit;
 - b. Paraqiten verejtjeve ndaj listës perfundimtare te shperndarjes.
 - c. Diskutim mbi vijimesine e procedures.
5. Anetaret e Komitetit te Kreditorëve kane te drejte te paraqesin ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane, komentverejtjet ne lidhje me llogarite perfundimtare te paraqitura nga administratorja, brenda 7 diteve nga dita e njoftimit te ketij vendimi. Mospermbushja e ketyre kriterëve formale ben verejtjet te papranueshme per shqyrtim.
6. Kreditorët e falimentimit kane te drejte te paraqesin me shkrim ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane, deri ne 7 dite para dates se caktuar, sipas pikes 3 te ketij vendimi, verejtjet ndaj listes perfundimtare te shperndarjes, nese ata kane. Nese kreditori i falimentimit eshte person juridik, kerkeses me shkrim duhet t'i bashkelidhet nje ekstrakt leshuar nga QKB (ne origjinal) dhe nje autorizim te posaçem leshuar nga



- administratori per perfaqesuesin. Mospermbushja e ketyre kriterëve formale ben kerkesen e papranueshme per shqyrtim.
- Nje kopje e ketij vendimi t'i njoftohet personalisht Administratores së Falimentimit Shpresa Breçani.
8. Nje kopje e ketij vendimi t'i njoftohet nga Administratorja e Falimentimit Shpresa Breçani, personalisht 4 anetareve te Komitetit te Kreditoreve.
 9. Nje kopje e ketij vendimi t'i njoftohet nga Administratorja e Falimentimit personalisht kreditoreve te falimentimit dhe debitorit Shoqerise "Albanian Airlines" shpk, ne falimentim.
 10. Nje kopje e ketij vendimi te shpallet publikisht ne faqen zyrtare te internetit te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, per efekt njoftimi publik.

.U shpall ne Tirane, sot me date 09.03.2018

**GJYQTARE
MARINELA OSMANI**

